



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3 Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 17.12.2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Z. BASHKIM BUDAKOVA** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Lipjan, nga subjekti politik "AAK" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal **z.Fitim Selimi**.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së , që ky vendim t'i komunikohet **z.Bashkim Budakova**, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të dozuara në KQZ më datën 15.12.2017, nr.2595/2017, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit z.Fitim Selimi, për arsyeje personale.

Andaj, duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatit të radhës sipas listës së rirenditur, i cili është z. Bashkim Budakova, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 17.12.2017

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve


Valdete Daka
Republika e Kosovës
Republika Kosova
Prishtinë
Prishtina
CENTRALNA IZBORNA KOMISIJA